



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202201040/5

Tiranë ___/___/2022

Lënda : *Rekomandim për analizimin e rastit të mos përpilimit dhe dhënies së procesverbaleve “Mbi veprimet e kryera me personin e shoqëruar” nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Tepelenë.*

KOMISARIATIT TË POLICISË
Tepelenë

DREJTORISË VENDORE TË POLICISË
Gjirokastrë

Për dijeni : **DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT**
Tiranë

Me shkresat nr. K2/23-2 prot., datë 31.08.20222 dhe nr. K2/23-3 prot., datë 23.09.2022, drejtuar Komisarariatit të Policisë Tepelenë kemi vënë në dijeni se në institucionin e Avokatit të Popullit kanë bërë ankesë shtetasit Z.I. etj.. Ankuesit shkruajnë se janë trashëgimtarët e ligjshëm të shtetasit A.D., i cili ka qenë pronar i një pasurie truall me sip. 642 m2 me shtëpi me sip. 82 m2, me nr. pasurie 577, zona kadastrale 3057, e ndodhur në fshatin Progonat të Njësisë Administrative Kurvelesh, rrethi Tepelenë, qarku Gjirokastrë.

Pronësinë e ligjshme mbi këtë send ata e vërtetojnë në bazë të dokumentit “Vërtetim të Listëpronësisë nr. 9”, të viteve 1948-1951, nxjerrë nga arkivi i Zyrës së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Bashkisë Tepelenë, e përditësuar në muajin shtator 2016 e në muajin nëntor 2021 dhe të definuar me Vendimin nr. 304, datë 13.04.2022 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, si pronarë të ligjshëm.

Gjatë procedurave për kthimin e këtij titulli pronësie në certifikatë pronësie, në zyrat e ASHK-së, DV Tepelenë, kanë rënë në dijeni të faktit se kjo pasuri gabimisht ishte regjistruar në regjistrat kadastralë në pronësinë e një bashkëfshatari të tyre, z. J.G., pa dijeninë e tij dhe pa pasur asnjë lidhje apo marrëdhënie juridike me këtë pronë.

Pas marrjes dijeni të këtij fakti, trashëgimtarët e përfituesit fiktiv J.G. (pasi ky person u nda nga jeta në vitin 2021) kanë dhënë 4 deklarata noteriale dorëheqjeje nga çdo e drejtë reale mbi këtë send, që nga ajo datë e në të ardhmen.

Meqenëse nga ASHK-ja nuk u erdhi asnjë përgjigje për aplikimin e tyre nr. 2298, datë 29.09.2021, ankuesit i janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, e cila është shprehur në vendimin e mësipërm në favorin e tyre dhe ka urdhëruar:

- Fshirjen nga Regjistrat Kadastralë të emrit të përfituesit fiktiv J.G. dhe regjistrimin e kësaj pasurie në emrat e tyre, trashëgimtarëve të ligjshëm të pronarit legjitim, A.D..

- Sigurimin e padisë mbi këtë pasuri, deri në zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje.

Ndërkohë, duke përfituar nga ky gabim i regjistrimit në regjistrat kadastralë dhe nga mosveprimi i ASHK-së Tepelenë, shtetasit K. dhe A.H. në datën 24.12.2021 u futën arbitrarisht në këtë banesë duke prishur murin hyrës për te porta kryesore dhe e zaptuan atë. Ndaj këtij veprimi të kundërligjshëm ankuesit kanë bërë kallëzim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrës, e cila e ka pushuar çështjen.

Meqenëse nuk iu zgjidh shqetësimi, në mënyrë të përsëritur ata i janë drejtuar për ndihmë institucionale Ministrisë të Brendshme, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Bashkisë Tepelenë, Administratorit të Njësisë Administrative Kurvelesh, Kryetarit të fshatit Progonat, Shefit të Komisarariatit të Policisë Tepelenë, Drejtorisë së Policisë së Qarkut Gjirokastër, SHÇBA-së (aktualisht AMP-së) Qendrore në Tiranë dhe asaj vendore të qarkut Gjirokastër, duke përcjellë materiale të përditësuara, përfshirë edhe vendimet e gjykatës.

Duke përfituar nga mosveprimet e institucioneve, shtetësja B.V., motra e zaptueses së banesës, A.H., ka bërë kërkesë padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, duke kërkuar të fshihej kjo pasuri nga përfituesi fiktiv J.G. dhe të regjistrohej në emrin e saj, por ajo nuk ka paraqitur asnjë dokument pronësie mbi këtë send.

Gjykata me vendimin nr. 299, dt. 11.04.2022 e rrëzoi kërkesë padinë e saj dhe ky vendim ka marrë formë të prerë në 24.04.2022, për shkak se nuk u ankimua nga paditësjja. Pasi vendimi mori formë të prerë, ankuesit u kanë kërkuar zaptuesve që të dilnin nga banesa e tyre. Zaptuesit i nxorën vet sendet e tyre dhe ankuesit duke e gjetur banesën të lirë, futën brenda saj sendet personale.

Edhe pse shtetaset A.H. dhe V.D. e liruan vet banesën, qëndruan në oborrin e saj dhe kanë thirrur policinë, e cila u ka kërkuar të shkonin në komisarariat për të sqaruar situatën e

krijuar. Ndërkohë, shtetësja L.Z.. dhe përfaqësuesi ligjor i ankuesve, avokat Z.I. shkuan vetë në Komisariatit e Policisë Tepelenë për të sqaruar këtë situatë duke paraqitur edhe dokumentet që disponojnë lidhur me pronësinë e kësaj banese.

Sipas ankuesve, në kohën që L. dhe Z.I. ndodheshin në komisarariat, pa dijeninë e tyre në banesë në Progonat ka shkuar Shefi i Komisarariatit z. Armand Koni, i shoqëruar me një furgon policie dhe kanë nxjerrë me dhunë 4 gra që ishin në atë çast në banesën e tyre.

Në momentin që L.I. dhe Z.I. mbërritën në banesë, aty gjetëm dy policë, të cilët i kanë njoftuar ata se, “Kemi urdhër të futemi në banesë” por ndërkohë nuk u dhanë asnjë dokument të nxjerrë nga organet kompetente për kryerjen e këtij veprimi.

Gjatë kohës që punonjësit e policisë rrinin te dera, ndërsa ankuesit në oborrin e banesës, i lejonin ata të futeshim të shoqëruar për të përdorur tualetin dhe për të marrë ndonjë send të nevojshëm (kuverta, ushqime, etj). Sipas ankuesve, punonjësit e policisë të vendosur në ambientet e kësaj prone u kanë plotësuar me korrektesë të gjitha kërkesat dhe nevojat e paraqitura dhe se ndaj tyre nuk kanë asnjë ankesë apo shqetësim.

Kjo gjendje ka vazhduar deri në mbrëmjen e datës 20.08.2022, kur në oborrin e banesës ishin L. dhe vajza e saj A., që po ndernin disa tesha. Aty kanë mbërritur disa punonjës policie, njëri prej të cilëve u prezantua me emër, Bledar Rushiti. Pa patur asnjë urdhër apo dokument shkresor, në mënyrë arbitrare ata kanë shqyer portën e jashtme, hynë brenda në oborr dhe i kanë nxjerrë nga oborri ankuesit duke i tërhequr zvarrë. Ndërkohë punonjësit e policisë kanë shoqëruar përfaqësuesin e tyre ligjor, Av. Z.I., i cili ndodhej jashtë banesës dhe jashtë portës së oborrit, fakt për të cilin pretendojnë se kanë pamje filmike.

Punonjësit e policisë i kanë shoqëruar në Komisarariatit e Policisë Tepelenë rreth orës 19.30 të datës 20.08.2022. Sapo kanë shkuar në komisarariat u kanë marrë aparatet e telefonit celular dhe nuk i kanë lejuar të telefonojnë familjarët apo ndonjë mbrojtës tjetër ligjor. Ndërsa në momentin që kanë bërë shoqërimin e tyre nuk i kanë lejuar që të merrnin as ilaçet që kishin në banesë. Sipas ankuesve, këto veprime janë bërë me urdhër verbal të punonjësit të policisë Bledar Rushiti.

Pas orës 01.00 të datës 21.08.2022 ka filluar marrja e tyre në pyetje, në cilësinë e personave nën hetim për akuzën “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit”. Rreth orës 04.00 të datës 21.08.2022, ata janë lënë të lirë dhe kur u kthyen në banesë në Progonat kanë konstatuar se brenda mjediseve të oborrit dhe të shtëpisë ndodheshin punonjësit e policisë të dërguar nga Komisarariatit i Policisë Tepelenë. Punonjësit e policisë i kanë njoftuar ata se, jo vetëm që nuk mund të futeshin më në banesë, por kishin urdhër të prerë të mos u jepnin asnjë nga sendet e tyre të nevojshme. Rreth orës 14.00 të datës 22.08.2022, punonjësit e policisë i lejuan ata që të merrnin nga banesa një karrige dhe një kuvertë dhe pas këtij momenti të dy punonjësit e policisë u larguan nga ambientet e banesës, duke lidhur portën e jashtme me një tel.

Ndodhur në këto rrethana ankuesit vazhdojnë të qëndrojnë jashtë banesës dhe oborrit të saj në pritje të urdhrin të policisë.

Ankuesit kërkojnë ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me veprimet e dhunshme dhe arbitrare të kryera nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Tepelenë ndaj tyre dhe cenimit të dinjitetit dhe të drejtës së gëzimit të pronës së ligjshme.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese, i kërkuam Komisarariatit të Policisë Tepelenë dërgimin e një informacioni mbi pyetjet si më poshtë vijon:

1. Cilat janë shkakut dhe baza ligjore e dërgimit të punonjësve të policisë në banesën e ankuesve të përmendur më sipër?
2. Cilat janë shkakut dhe baza ligjore e futjes së punonjësve të policisë në banesën e ankuesve dhe nxjerrjen e tyre me dhunë jashtë saj?
3. Cilat janë shkakut dhe baza ligjore e shoqërimit të ankuesve në mjediset e Komisarariatit të Policisë Tepelenë?
4. A janë të vërteta pretendimet e ankuesve L.I. dhe Av. Z.I. se pasi janë shoqëruar në polici u janë hequr aparatet e telefonit celular dhe nuk janë lejuar të telefonojnë familjarët apo ndonjë avokat? Nëse po, cila është baza ligjore e këtij veprimi?
5. A janë të vërteta pretendimet e ankuesve se ata janë urdhëruar nga policia që të mos futen në banesë dhe në oborrin e saj? Nëse po, cila është baza ligjore e këtij veprimi apo urdhri/vendimi që keni zbatuar lidhur me këtë veprim?
6. Çfarë veprimesh procedurale janë kryer nga Komisarati i Policisë Tepelenë lidhur me këtë rast?

Bashkë me informacionin kërkuam dërgimin edhe të fotokopjeve të fletëve të regjistrin të shtetasve të shoqëruar në polici në të cilat janë pasqyruar gjeneralitetet e ankuesve, të formularëve të raporteve të shoqërimit, të procesverbaleve mbi veprimet e kryera me personat e shoqëruar, si dhe të dokumenteve të administruara lidhur me këtë rast.

Komisariati i Policisë Tepelenë me shkresën nr. 57/1 prot., datë 28.09.2022 ndërmjet të tjerave na informoi se, ky organ është marrë me trajtimin e këtij problemi që nga data 23.12.2021, në fillesat e tij dhe në vazhdim pa ndërprerje.

Konflikti ka nisur në muajin dhjetor të vitit 2021 për shkak të një banese në fshatin Progonat, Njësia Administrative Kurvelesh, Bashkia Tepelenë, banesë në të cilën nga viti 1986 e deri në muajin qershor të vitit 2021 ka jetuar shtetasja A.D., e ëma e shtetaseve A.H., B.V. dhe V.D., të cilat pretendojnë se kjo banesë është ndërtuar nga themelet nga e ëma, vetë ato dhe me ndihmesën e bashkëfshatarëve pasi ka qenë një familje në kushte të vështira ekonomike. Deri në muajin qershor 2021, kohë kur shtetësja A.D. ka qenë gjallë,

marrëdhëniet ndërmjet dy familjeve kanë qenë të mira deri në momentin kur palët kanë filluar pretendimet për pronësinë e saj. Shtetësja A.H. dhe motrat e saj janë shprehur se në lidhje me truallin nuk e dinë me saktësi se në pronësi të kujt ka qenë, pasi aty ka jetuar fisi Daci dhe se shtëpia shkak i konfliktit është ndërtuar në themelet e një hauri (kasolleje) ku ka jetuar A.D. bashkë me fëmijët e saj jetimë. Kjo ndërtesë është ndërtuar fillimisht me punën e A., fëmijëve të saj, të afërmeve të tyre dhe banorëve të fshatit të cilët kanë ndihmuar vullnetarisht dhe se për këtë fakt ka dëshmitarë të cilët janë ende gjallë në Progonat.

Në muajin dhjetor 2021, shtetësja L.D., Sh.D. dhe avokat Z.I., janë paraqitur në Komisarjatin e Policisë Tepelenë dhe kanë ngritur pretendimet e tyre mbi banesën në fjalë. Atyre u është marrë kallëzimi, janë thirrur të dy palët dhe u janë marrë deklaratime. Materialet procedurale janë referuar për vlerësim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë me shkresën nr. 2332 prot., datë 28.12.2021 dhe nr. 2354 prot., datë 30.12.2021. Ndërkohë palët janë orientuar që për zgjidhjen përfundimtare të konfliktit të pronësisë t'i drejtohen gjykatës kompetente dhe se çdo veprim i ndërmarrë me iniciativën e tyre mund të sjellë konsumimin e elementëve të veprës penale të "Vetëgjyqësisë", parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal.

Nga Komisarjati i Policisë Tepelenë me shkresën nr. 147 prot., datë 31.01.2022, drejtuar ASHK-së, Drejtoria Vendore Tepelenë, i është kërkuar informacion për gjendjen juridike të pronës shkak i këtij konflikti. Ndërsa me shkresën nr. 148 prot., datë 31.01.2022 i është dërguar për dijeni dhe marrje masash për konfliktin e pronësisë Njësisë Administrative Kurvelesh dhe Bashkisë Tepelenë, ku kërkohet që konflikti të trajtohet nga ana e tyre duke vënë në dispozicion dokumentacionin që dispononin në lidhje me këtë pasuri objekt i konfliktit.

Me shkresën nr. 130/1 prot., datë 01.02.2022, ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tepelenë ka kthyer përgjigje, se nga verifikimi i gjendjes juridike të pasurisë së kërkuar ka rezultuar se pasuria me nr. 577, është pasuri e regjistruar në Vol. 6, fq. 80, ZK 3057 Progonat, e llojit truall dhe ndërtesë me sip. totale 200 m² dhe sip. ndërtimore 82 m², në pronësi të shtetasit J.G.. Kjo pasuri është regjistruar në bazë të listës së trojeve të fshatit Progonat në zbatim të VKM nr. 432, datë 14.08.1995.

Në vijimësi, shtetësja L.I., Av. Z.I. dhe shtetësja Sh.G. kanë kërkuar vazhdimisht që Komisarjati i Policisë Tepelenë të nxjerrë me forcë nga banesa shtetasen A.H. (vajza e A.D.), e cila jetonte në këtë banesë. Shtetasit e përmendur më sipër janë sqaruar se strukturat e policisë nuk mund të kryejë veprimet e kërkuara prej tyre pasi ato janë jashtë kompetencës lëndore të Policisë së Shtetit dhe se për zgjidhjen e këtij konflikti duhet t'i drejtohen gjykatës kompetente. Gjithashtu ata janë sqaruar se pas marrjes së vendimit nga gjykata, duhet t'i drejtohen Zyrës Përmbartimore për ekzekutimin e vendimit dhe nëse kanë nevojë për mbështetjen e Policisë për shmangjen e konfliktit fizik, t'i drejtohen me kërkesë Komisarjati të Policisë Tepelenë. Aktualisht në këtë komisarjat nuk është paraqitur ndonjë kërkesë nga ndonjë Zyrë Përmbartimore për ekzekutimin e vendimit gjyqësor nr. 304, datë 13.04.2022 të Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Gjithashtu, në këtë përgjigje vihemi në dijeni se shkak i dërgimit të punonjësve të policisë në banesën në fjalë ka qenë për arsye se në datën 18.08.2022, ora 15:20, në sallën Operative të Komisarariatit të Policisë Tepelenë ka ardhur një telefonatë për një konflikt që po ndodhte në fshatin Progonat. Menjëherë pas ardhjes së këtij njoftimi, janë organizuar shërbimet e policisë dhe në vend kanë shkuar Shefi i Rendit Nënkomisar Erald Telo, Nënkomisar Esmerald Bega me detyrë specialist për hetimin e krimeve, Inspektor Vilson Kanani me detyrë SPZ dhe patrulla e përgjithshme e planifikuar me shërbim turni i dytë. Rreth orës 15:40 shërbimet e policisë kanë mbërritur në vend në fshatin Progonat dhe janë kontaktuar nga shtetësja A.H. dhe motra e saj shtetësja V.D. të cilat u kanë treguar ngjarjen e ndodhur. Në momentin e mbërritjes, forcat e policisë kanë konstatuar mobilje e sende të tjera shtëpiake të vendosura në mënyrë të çrregullt si brenda rrethimit të banesës dhe jashtë saj (faktuar kjo edhe me fotografimin e vendit të ngjarjes).

Pasi punonjësit e policisë janë informuar për arsyet e konfliktit të ndodhur, të cilat ishin pretendimet për pronësinë e banesës, kanë kryer veprimet procedurale dhe këqyrjen e vendit të ngjarjes pasi shtetësja V.D. ka bërë kallëzim për dhunimin e saj dhe të banesës në të cilën ka jetuar nëna e saj. Ajo ka deklaruar se rreth orës 15:00 të datës 18.08.2022 i kanë shkuar në banesë disa shtetas burra e gra, të cilët i kanë kërkuar që të dilte nga banesa me pretendimin se ajo ishte e tyre. Ata janë futur me forcë në banesë dhe pa miratimin e saj duke shqyer me forcë derën e jashtme. Pas hyrjes në banesë ata kanë nxjerrë jashtë të gjitha plaçkat (mobiljet, frigoriferin, karrige, etj). Ndërkohë atë e ka kapur me forcë nga krahët dhe e ka tërhequr zvarrë një grua që më vonë është identifikuar si G.L.. Gjatë tërheqjes me forcë G. e ka rrëzuar V. dhe pas rënies asaj i janë shkaktuar dëmtime në të dy gjunjët.

Në përgjigjen e dërguar nga komisarati u informuam se, nga veprimet e para hetimore rezulton se deklaramet e ankuesve që shtetaset A.H. dhe V.D. e kanë liruar vetë banesën, nuk qëndrojnë.

Sipas Komisarariatit të Policisë Tepelenë, në lidhje me këtë ngjarje është pyetur edhe shtetasi Z.M. me detyrë kryetar i fshatit Progonat, i cili ka deklaruar se ka lindur dhe banon në këtë fshat dhe objekti në konflikt është ndërtuar nga shtetësja A.D. në vitin 1987, por në vitin 2002 në hipotekën e qytetit Tepelenë kjo shtëpi është regjistruar në emër të shtetasit J.G.. Ky konflikt ka filluar pas vdekjes së shtetasës A.D. në muajin qershor të vitit 2021. Sipas tij, nga viti 1987 dhe deri në vitin 2021 në këtë banesë ka jetuar shtetasja A.D. me djalin e saj të quajtur L.D., i cili ka ndërruar jetë para disa vitesh. Shtetësja A.D. ka vijuar të banojë në këtë banesë deri në muajin qershor 2021, kohë kur ajo ka ndërruar jetë. Ndërsa pas vdekjes së A. në këtë banesë ka banuar vajza e saj e quajtur A.H..

Nga verifikimet e bëra nga komisarati ka rezultuar se asnjëra nga palët në konflikt nuk ka çertifikatë pronësie të kësaj banese. Dokumentacioni përpiluar dhe administruar nga ky organ i është referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër dhe se për çdo rast të këtij konflikti punonjësit e policisë janë konsultuar me prokurorin e gatshëm.

Gjithashtu, në këtë përgjigje u informuam se, shkakut dhe baza ligjore e futjes së punonjësve të policisë në këtë banesë janë parandalimi i ardhjes së pasojave që mund të vinin nga konflikti i ndodhur ndërmjet dy palëve, kërkimi i autorëve, kryerja e hetimeve dhe grumbullimi i provave bazuar në nenin 30 të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa shoqërimi i ankuesve në komisariat është bërë në bazë të nenit 109/c/ç të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, *“kur ka dyshime se ka kryer një veprë penale”* dhe *“për të parandaluar një veprë penale”*.

Ndodhur në këto rrethana dhe pas komunikimit me prokurorin e gatshëm, nga punonjësit e policisë iu është kërkuar palëve për t’u paraqitur në komisariat për kryerjen e veprimeve procedurale. Meqënëse ato e refuzuan këtë kërkesë, atëherë nëpërmjet forcave “Shqiponja” është bërë shoqërimi i tyre në komisariat, ku e pranishme ka qenë edhe një punonjëse policie femër. Si gjatë shoqërimit ashtu edhe në ambientet e komisaritit nuk është ushtruar dhunë ndaj të shoqëruarve. Ndërkohë për të bërë të mundur parandalimin e ndodhjes së ndonjë ngjarjeje kriminale, në këtë banesë është dislokuar një patrullë policie. Pas kryerjes së veprimeve procedurale, është vendosur që të procedohen në gjendje të lirë shtetasit si më poshtë vijon:

G.L. për veprën penale “Dhunimi i banesës”, “Vetëgjyqësia” dhe “Dëmtime të tjera me dashje”, të parashikuara nga nenet 112/2, 277 dhe 90 të Kodit Penal; Sh. e F. G., A.Z. I. dhe V.C. për veprat penale “Dhunimi i banesës” dhe “Vetëgjyqësia”, të parashikuara nga nenet 112/2 dhe 277 të Kodit Penal.

Në datën 20.08.2022, në orën 16:00, patrulla e përgjithshme e planizuar me shërbim në fshatin Progonat ka njoftuar komisaritit se kanë shkuar në banesën objekt konflikti shtetasit A.I., Z.I. dhe L.I. të cilët janë futur në ambientet e banesës duke kundërshtuar punonjësit e policisë.

Pas marrjes së këtij njoftimi është komunikuar me prokurorin e gatshëm dhe në vend janë dërguar shërbime policie shtesë. Nga punonjësit e policisë është komunikuar me shtetasit e përmendur më sipër të cilët ndodheshin brenda rrethimit të banesës duke iu thënë se ishin në kushtet e veprës penale të “Vetëgjyqësisë”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal. Por ata i kanë bërë presion punonjësve të policisë dhe kanë vazhduar me kundërshtimet e tyre. Ndodhur në këto rrethana kur shtetasit në fjalë nuk kanë ndjekur rrugën ligjore për të marrë banesën e pretenduar si pronë të tyre dhe ndërkohë kanë kundërshtuar punonjësit e policisë për t’u larguar nga kjo banesë, është bërë shoqërimi i tyre në komisariat konform rregullave të parashikuara në Procedurën standarde, si dhe duke qenë e pranishme edhe një punonjëse policie femër.

Materialet procedurale të përpiluara për këtë rast i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjyrokastër me shkresën nr. 1287 prot., datë 22.08.2022 dhe për çdo veprim të kryer nga policia është marrë konsultë nga prokurori i gatshëm.

Po ashtu në këtë përgjigje u informuam se në asnjë moment të shoqëruarve nuk iu është mohuar e drejta për të komunikuar me familjarët apo me avokatin, por në bazë të

procedurave standarde që normojnë punën e Policisë së Shtetit për rregullat e shoqërimit, pas njoftimit të familjarëve dhe mbrojtësit, telefonat u hiqen për arsye sigurie.

Së bashku me informacionin Komisariati i Policisë Tepelenë na dërgoi edhe fotokopje të 6 shkresave përcjellëse për dërgimin e materialeve procedurale Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë lidhur me këtë konflikt, shkresa që i përkasin periudhës kohore nga data 28.12.2021 deri në datën 07.09.2022, të formularëve të raporteve të shoqërimit në komisarikat të ankuesve dhe të fletëve të regjistrimit të shoqërimit. Por, nga ana tjetër konstatohet se pavarësisht kërkesës tonë, nuk na u dërguan kopjet e procesverbaleve të veprimeve të kryera me të shoqëruarit.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese dhe i përgjigjes së dërguar nga Komisariati i Policisë Tepelenë konstatohet se:

1. Veprimet e punonjësve të Komisarikatit të Policisë Tepelenë lidhur me këtë rast, si vajtja e hyrja në objektin në fjalë në konflikt pronësie, këqyrja e vendit të ngjarjes, shoqërimi i shtetasve të përmendur më sipër dhe kryerja e veprimeve të tjera procedurale janë bërë mbi bazën e kërkesës dhe kallëzimit të bërë nga shtetaset A.H. dhe V.D., të cilat banonin në këtë banesë. Qëllimi i hyrjes në banesë ka qenë administrimi dhe ndjekja e kallëzimit të bërë në përputhje me aktet normative në fuqi të cilat rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit dhe të policisë gjyqësore, si dhe parandalimi i ndonjë ngjarjeje të rëndë kriminale ndërmjet palëve në konflikt.

2. Heqja e telefonave të të shoqëruarve, ndonëse nga Komisariati i Policisë Tepelenë justifikohet si veprim i kryer për arsye sigurie dhe konform procedurës standarde të punës, në fakt nuk është një veprim korrekt. Ai vjen në kundërshtim me frymën e Procedurës standarde të punës¹ “Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Sipas kësaj procedurë, personit të shoqëruar i bëhet një kontroll përfaqësor në momentin e kapjes dhe i hiqen sendet rrezikshme apo të kundërligjshme që mund të ketë me vete. Kjo procedurë bëhet me qëllim për sigurinë e shëndetit dhe jetës së tij, të punonjësve të policisë që bëjnë shoqërimin apo e personave të tjerë, për

¹ VII. “PROCEDURA TË DOKUMENTIMIT TË VEPRIMIT TË SHOQËRIMIT”

a.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar:

a.3.1 - Pas kryerjes së veprimeve të verifikimit të rastit për personin e shoqëruar, nga punonjësi i policisë hartohet procesverbali i dokumentimit të veprimeve të kryera me personin e shoqëruar.

a.3.2 - Ky procesverbal pasi plotësohet duke hedhur të gjithë të dhënat sipas përcaktimeve dhe rubrikave të përcaktuara në të, nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe nga vetë personi i shoqëruar.

a.3.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar plotësohet nga punonjësi i policisë që është ngarkuar të kryejë verifikimin dhe trajtimin e çështjes përkatëse për personin e shoqëruar.

a.3.4 - Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimisht personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.

Mos plotësimi i procesverbalit dhe mos dhënia e një kopjeje personit të shoqëruar përbën shkelje të rëndë dhe ndëshkohet sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Policisë.

administrimin e sigurimin e provave materiale për veprën për të cilën dyshohet se ka kryer, si dhe kryerjen e detyrës ligjore të ngarkuar në kuadër të misionit ligjor të Policisë së Shtetit.

Ne vlerësojmë se për rastin në fjalë, veprat penale për të cilat dyshohen se i kanë kryer ankuesit dhe pa anashkaluar personalitetin e tyre, nuk është korrekte dhe e bazuar që t'u hiqeshin telefonat në momentin që janë futur në mjediset e Komisarariatit të Policisë Tepelenë. Aparatet e telefonit në këtë rast nuk ishin sende të kundërligjshme dhe as sende rrezikshme që mund të cënonin jetën e tyre, atë të punonjësve të policisë dhe sigurinë e institucionit/komisariatit.

3. Në rastin në shqyrtim nga punonjësit e policisë që kanë punuar me ankuesit e shoqëruar shtetasit Z.I. etj. nuk janë përpiluar e dhënë kopjet e procesverbaleve të veprimeve të kryera me të shoqëruarit. Ky qëndrim/mosveprim vjen në kundërshtim të plotë dhe të hapur me nenin 109/5 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe me Kreun e VII-të, pika 1, gërma “a.3” të Procedurës standarde të punës² “Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ndërsa referuar gërmës “a.3.4”, paragrafi i fundit të saj, mos plotësimi i procesverbalit dhe mos dhënia e një kopjeje personit të shoqëruar përbën shkelje të rëndë dhe ndëshkohet sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Policisë.

Është rasti të theksojnë se kjo shkelje e të drejtës ligjore të të shoqëruarve nga punonjësit e policisë dhe e detyrimit të këtyre të fundit është evidentuar edhe më parë nga ana jonë. Ndonëse në disa rekomandime që u janë adresuar në vijimësi nga institucioni i Avokatit të Popullit strukturave vendore e qendrore të Policisë së Shtetit është trajtuar ky shqetësim dhe është rekomanduar përmirësimi i punës, me keqardhje konstatojmë se raste të tilla përsëriten në praktikën e përditshme.

Ky fakt tregon se nuk njihen në nivelin e duhur aktet normative ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit dhe detyrimet e punonjësve të policisë për të zbatuar e respektuar të drejtat e shtetasve të shoqëruar në mjediset e Policisë së Shtetit.

² VII. “PROCEDURA TË DOKUMENTIMIT TË VEPRIMIT TË SHOQËRIMIT”

a.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar:

a.3.1 - Pas kryerjes së veprimeve të verifikimit e sqarimit të rastit për personin e shoqëruar, nga punonjësi i policisë hartohet procesverbali i dokumentimit të veprimeve të kryera me personin e shoqëruar.

a.3.2 - Ky procesverbal pasi plotësohet duke hedhur të gjithë të dhënat sipas përcaktimeve dhe rubrikave të përcaktuara në të, nënshkruhet në fund të çdo faqeje nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe nga vetë personi i shoqëruar.

a.3.3 - Proces verbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar plotësohet nga punonjësi i policisë që është ngarkuar të kryejë verifikimin dhe trajtimin e çështjes përkatëse për personin e shoqëruar.

a.3.4 - Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimisht personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.

Mos plotësimi i procesverbalit dhe mos dhënia e një kopjeje personit të shoqëruar përbën shkelje të rëndë dhe ndëshkohet sipas përcaktimeve të bëra në Rregulloren e Policisë.

Gjithashtu vlerësojmë se një ndër shkaqet e përsëritjes së kësaj shkeljeje të të drejtave të qytetarëve është edhe mos ushtrimi i kontrollit të strukturave drejtuese të punonjësve të policisë ndaj vartësve të tyre.

Theksojmë se qëndrimet jo ligjore të mbajtuara në këto raste nga punonjësit e policisë cenojnë rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe besimin e publikut tek ky organ, të cilat janë të domosdoshme në kryerjen me sukses të misionit ligjor të saj për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, *si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, gjykon se bazuar në evidentimin e problematikës të lartpërmendur, lind nevoja e një reagimi më të fortë nga strukturat e Policisë së Shtetit, për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve të shoqëruar në ambientet e komisariateve/stacioneve të policisë në përputhje me aktet normative në fuqi.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të nevojshme nga DVP Gjirokastrë për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësve të Komisarariatit të Policisë Tepelenë që kanë kryer veprime procedurale me shtetasit Z.I. etj., për heqjen e aparateve të telefonit celular dhe për mos përpilimin e dhënien e kopjeve të procesverbaleve për veprimet e kryera me personin e shoqëruar, sikurse parashikohet në nenin 109/5 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe në Kreun e VII-të, pika 1, gërma “a.3” të Procedurës standarde të punës “Rregullat për trajtimin e shtetasve të shoqëruar në mjediset e policisë”, miratuar me Urdhrin nr. 894, datë 19.07.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

2. Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për të ushtruar kontroll në mënyrë të vijueshme në të gjitha strukturat vendore të policisë lidhur me zbatimin e kriterëve të shoqërimit të shtetasve në ambientet e policisë dhe respektimin e të drejtave ligjore të të shoqëruarve, duke përfshirë edhe përpilimin dhe dhënien e procesverbalit për veprimet e kryera me të shoqëruarit.

3. Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për trajnimin në vijimësi të punonjësve të Policisë së Shtetit lidhur me njohjen e akteve

normative që rregullojnë veprimtarinë e këtij organi, rastet dhe kriteret e shoqërimit dhe respektimin e të drejtave ligjore të personave të shoqëruar.

4. Marrjen e masave të menjëhershme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për përgjithësimin e këtij rasti në strukturat vendore të Policisë së Shtetit me qëllim që shkelje të tilla të mos përsëriten në të ardhmen dhe për të garantuar besimin e vazhdueshëm të publikut tek ky organ i administratës publike.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi